



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 2976/ 12 prot.

Datë 24/01/2024

**V E N D I M**

**Nr. 79/2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 24/01/2024, mori në shqyrtim çështjen me,

**Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1378/2023, datë 28.12.2023 për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-84498-10-20-2023, me objekt: “Blerje pajisje elektrike për pastrimin e hapësirave urbane”, me fond limit 7.080.000 (shtatë milion e tetëdhjetë mijë) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 09.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Trade and Construction Group” SHPK me Nipt M11320022Q, me adresa: Rruga “Marko Bocari”, pallati “TID”, Shkalla 1, Apartamenti 3, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:** Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.  
Adresa: Rruga “Xhezmi Delli”, Godina nr.20, Tiranë..

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit

*Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID - 19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

**Vëren:**

**I**

*Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datë 28.12.2023, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1378/2023, ku vendosi:

- 1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Trade and Construction Group” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-84498-10-20-2023, me objekt: “Blerje pajisje elektrike për pastrimin e hapësirave urbane”, me fond limit 7.080.000 (shtatë milion e tetëdhjetë mijë) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 09.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.*
- 2. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Trade and Construction Group” SHPK për procedurën e prokurimit më sipër cituar.*
- 3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Trade and Construction Group” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.*
- 4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
- 5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operator ekonomik “Trade and Construction Group” SHPK.*
- 6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
- 7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

I.2. Me anë të shkresës nr. 21/5 prot., datë 09.01.2024, protokolluar me tonën nr. 2976/9 prot., datë 17.01.2024, autoriteti kontraktor Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit njofton se ka zbatuar vendimin Nr. 1378/2023, datë 28.12.2023, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-84498-10-20-2023, me objekt: “Blerje pajisje elektrike për pastrimin e hapësirave urbane”, me fond limit 7.080.000 (shtatë milion e tetëdhjetë mijë) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 09.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.

**II**

**Komisioni i Prokurimit Publik**

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

**Arsyeton**

II.1. Me anë të shkresës nr. 21/5 prot., datë 09.01.2024, protokolluar me tonën nr. 2976/9 prot., datë 17.01.2024, autoriteti kontraktor Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit njofton se ka zbatuar vendimin Nr. 1378/2023, datë 28.12.2023, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-84498-10-20-2023, me objekt: “Blerje pajisje elektrike për pastrimin e hapësirave urbane”, me fond limit 7.080.000 (shtatë milion e tetëdhjetë mijë) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 09.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet se, autoriteti kontraktor ka kryer rivlersimin e procedurës së prokurimit duke kualifikuar operatorin ekonomik ankimues “Trade and Construction Group” SHPK në përputhje me vendimin Nr. 1378/2023, datë 28.12.2023, të Komisionit të Prokurimit Publik.

II.2. Sa më sipër, autoriteti kontraktor Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit ka zbatuar vendimin Nr. 1378/2023, datë 28.12.2023, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, nenit 46 pika 2 e Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-84498-10-20-2023, me objekt: “Blerje pajisje elektrike për pastrimin e hapësirave urbane”, me fond limit 7.080.000 (shtatë milion e tetëdhjetë mijë) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 09.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**

